



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
MINISTARSTVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION

KUSHTET E VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ("Autoriteti Kontraktues"),

dhe

Ndërmarrja Tregatre Grafike "Blendi", Prishtinë

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS:

"Furnizim për zyre "

Numri i identifikimit: 212 19 4918 136

Numri i brendshëm: 212 19 011 136

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,

20 Gushtë 2019

Nr. i Prokurimit: 212 19 4918 136 & 212 19 011 136 Titulli: "Furnizim për zyre"

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: "Furnizim për zyre "

Nr. i Artikullit	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi pa TVSH €	TVSH (%)	Çmimi njësi me TVSH €	Çmimi total me TVSH €	Koha dërgese
1.	Suvenir për takimet e delegacioneve zyrtare	Copë	50	15.00	18 %	17.70	885.00	10 ditë
2.	Banera me logo të MAPL-së	Copë	2	25.00	18 %	29.50	59.00	10 ditë
3.	Bluza me logo të MAPL-së (sportive)	Copë	15	3.00	18 %	3.54	53.10	10 ditë
4.	Bluza me logo të MAPL-së (T-shirt)	Copë	13	3.00	18 %	3.54	46.02	10 ditë
5.	Lapsa kimik me logo të MAPL-së (metal)	Copë	100	0.20	18 %	0.24	23.60	10 ditë
6.	Lapsa kimik me logo të MAPL-së (dru ekologjik)	Copë	300	0.30	18 %	0.35	106.20	10 ditë
7.	Folldera të dizajnuar me logo të MAPL-së	Copë	292	0.80	18 %	0.94	275.65	10 ditë
8.	Fasiklla me logo të MAPL-së	Copë	100	0.90	18 %	1.06	106.20	10 ditë
9.	Llamp për tavolinë	Copë	1	25.00	18 %	29.50	29.50	10 ditë
10.	Mbajtëse për dokumente	Copë	6	1.50	18 %	1.77	10.62	10 ditë
11.	Pllaka metalike – mirënjohjet për punëtorët e dalluar dhe partnerët	Copë	15	3.50	18 %	4.13	61.95	10 ditë
12.	Aksesorë komplet lëkure	Komplet	1	25.00	18 %	29.50	29.50	10 ditë
Total i Përgjithshëm:							1,686.34 €	

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit: me 20.08.2019. Kohëzgjatja e kontratës fillonë nga data: 20.08.2019 deri me 19.02.2020. Furnizimet fillojnë nga data: 20.08.2019 në afat prej 10 ditësh kalendarike sipas afatit të liferimit.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **[90]** ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i **[dërgimit të furnizimeve]** [ekzekutimit të punëve] [kryerjes së shërbimeve] do të jetë: **Ndërtesa e ish "Rilindjes", kati i 12, Salla nr.1220, Divizioni i Prokurimit MAPL, Prishtinë**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **1,686.34 €** [redacted]
Njëmijë e gjashtë qind e tetë dhjetë e gjashtë euro e tridhjetë e katër centë [redacted].

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[redacted]
[redacted]

[redacted]
[redacted]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të [REDAKTUAR] [REDAKTUAR]

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [REDAKTUAR] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

Adresa e Autoritetit Kontraktues:

**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
Ndërtesa e ish "Rilindjes", kati i 12, Salla nr.1220, Divizioni i Prokurimit MAPL, Prishtinë**

Personi përgjegjës i prokurimit i Autoritetit Kontraktues

Emri dhe Mbiemri: **Shkelzen Hoxha**
Titulli: **Zyrtar i Prokurimit**
Nr. i Tel: + 381 (038) 200 35 614
E-maili: **shkelzen.hoxha@rks-gov.net**

Menaxher i proketit nga MAPL-ja:


Emri dhe Mbiemri: **Vjosa Shehu**
Titulli: **U.D Udhëheqëse e Divizionit për Bashkpunim Ndër Kufitar**
Nr. i telefonit: 038/ 200 35 592
E-mail: **Vjosa.shehu@rks-gov.net**

Adresa e Kontraktuesit:

Ndërmarrja Tregatre Grafike "Blendi", Prishtinë
Numri i Biznesit: 80077076
Nr. i llogarisë bankare: 1701001010609652 NLB
Menaxheri i projektit nga Operatori Ekonomik
Emri dhe Mbiemri: **Leonard Beqiri**
Titulli: **Punonjës**
Nr. i telefonit: **+383 44 916 288, +383 44 539 129**
E-mail: **shtypshkronjablendi@gmail.com**

Nr. i Prokurimit: 212 19 4918 136 & 212 19 011 136 Titulli: "Furnizim për zyre"

E hartuar në gjuhën **Shqipe**² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		Për Operatorin Ekonomik: Ndërmarrja Tregtare Grafike "Blendi", Prishtinë	
Emri:	Shkelzen Hoxha	Emri:	Leonard Begliu
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Punonjës
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.08.2019	Data:	20.08.2019
Vula:		Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.